



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE INF.SJP-A

Lënda: *Informacion i Drejtorisë së menaxhimit të Burimeve Njerëzore për Konkursin Punonjës Administrative në:*

Fakulteti i Artit Skenik//Njësia Bazë Regji, Regji Filmi & TV dhe Njësia Bazë Aktrim & Teori,

- **Specialist programi i studimit Regji, Regji Filmi & TV dhe programi i studimit Aktrim & Teori,**

REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Në vijim të procedurës së konkurrimit, për pozicionin **Specialist programi i studimit Regji, Regji Filmi & TV dhe programi i studimit Aktrim & Teori**, në Fakultetin e Artit Skenik pranë Uart, shpallur në Buletinit e Njoftimeve Publike nr. 46, datë 25/08/2025 dhe në Faqen zyrtare elektronike të Uart, paragrafi i fundit *citon: dosjet e kandidatëve do të dorëzohen në Dr. MBNJ nga data 25/08/2025 – 09/09/2025 ora 14.00*, për arsye të festës zyrtare data përfundimtare e dorëzimit të dosjeve ishte 10/09/2025 ora 14.00.

Pranë zyrës së Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore 3(tre) dosje:

1. **Mauro Zaçe - mbaruar Uart, Fakulteti i Artit Skenik, MA Regji Filmi & Tv dhe mësuesi;**
2. **Arbër Jakllari - mbaruar Uart, Fakulteti i Artit Skenik, MA Regji Teatri & Spektakli;**
3. **Klodian Çelmeta- mbaruar Uart, Fakulteti i Artit Skenik, MA Regji Teatri & Spektakli**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

Nr. 1532 Prot.

Tiranë, më 26/09/2025

URDHËR

Nr. 114, datë 26/09/2025

PËR

**CAKTIMIN E DATËS SË KONKURSIT DHE NGRITJEN E KOMISIONIT *AD HOC*
PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATIT FITUES PËR POZICIONIN "SPECIALIST
NË: PROGRAMIN E STUDIMIT REGJI FILMI & TV DHE PROGRAMIN E
STUDIMIT AKTRIM", PRANË FAKULTETIT TË ARTIT SKENIK, NË
UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin e Universitetit të Arteve, në shkresën e Rektorit datë 20.08.2025 me lëndë "Botim njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike" si dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 46, datë 25.08.2025,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Komisionit *ad hoc* me 3 (tre) anëtarë, për përzgjedhjen e kandidatit fitues për pozicionin "Specialist në: Programin e studimit Regji Filmi & TV dhe Programin e Studimit Aktrim", pranë Fakultetit të Artit Skenik, në Universitetin e Arteve.
2. Caktimin e Përgjegjësit të Sektorit Juridik, znj. Adela Kusuri, pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore SJ & I-PA, anëtare e caktuar nga Rektori në këtë komision.
3. Fakulteti i Artit Skenik të caktojë me urdhër 2 (dy) përfaqësuesit e tij në Komisionin *ad hoc* dhe të përcjellë këtë dokument për njohje dhe zbatim.
4. Konkursi do të zhvillohet me datë 02/10/2025, ora 11:00.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sektori Juridik pranë DMBNJ ISJ-P/A, Fakulteti i Artit Skenik dhe Drejtori i DMBNJ ISJ-P/A për njoftimin e kandidatëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


REKTORI
Prof. Dr. Erald Bakalli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE INF.SJP-A

Lënda: *Informacion i Drejtorisë së menaxhimit të Burimeve Njerëzore për Konkursin Punonjës Administrative në:*

Fakulteti i Artit Skenik//Njësia Bazë Regji, Regji Filmi & TV dhe Njësia Bazë Aktrim & Teori,

- **Specialist programi i studimit Regji, Regji Filmi & TV dhe programi i studimit Aktrim & Teori,**

Të nderuar konkurrencte, për pozicionin **Specialist programi i studimit Regji, Regji Filmi & TV dhe programi i studimit Aktrim & Teori:**

1. **Mauro Zaçe**
2. **Arbër Jakllari**
3. **Klodian Çelmeta**

Ju njoftojmë se Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Universitetit (Rektoratit) më datë 02/10/2025 ora 11.00 testimi me shkrim, ora 13.00 intervista e strukturuar.

Ju uroj suksese,

